

Si bëhet kërkesa për informacion?

Bazuar në nenin 11 të ligjit nr 119/2014, kërkesa për informacion bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë, ose me postë elektronike në adresat e SHRUKF. Kërkesa për informim duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin e kërkesit, adresën postare dhe elektronike ku dërgohet kërkesa, përshkrimin e informacionit që kërkohet dhe formatin në të cilin preferohet përgjigja. Brenda 10 ditë pune nga marrja në dorëzim e kërkesës për informacion, SHRUKF është e detyruar të kthejë përgjigje, përvç rasteve kur kërkohet informacion shtesë nga një autoritet tjetër publik. (Bashkangjitur edhe formati model i kërkesës për informacion).

E-mail: info.ukf@ukrf.al

E-mail: info.ukf@ukrf.al

Adresa: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier, Lagja “1 Maji” Rruga “Adriatiku” Fier

Hapat shpjegues për ankesën.

Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.

Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.